

# POLITIKAT NË FOKUS: LIGJI PËR INVESTIMET STRATEGJIKE



## Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

'Politikat në Fokus' është publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (Oda Amerikane) që ka për synim në baza dy-mujore të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat në vend. Ligji për Investimet Strategjike i aprovuar së fundi është temë e këtij publikimi, në mënyrë që të sqarohen synimet e ligjit dhe procedurat e aplikueshme që një investim të llogaritet si "investim strategjik" në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, ky ligj analizohet në kontekst rajonal, duke u krahasuar me ligje të ngjashme të aplikueshme në Shqipëri, Kroaci, Serbi dhe Maqedoni.

*Megjithatë, duhet të theksohet se në kohën e publikimit, ligji në fjalë edhe pse ka marrë aprovimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i njëjti është kontestuar pranë Gjykatës Kushtetuese nga Grupi Parlamentar i Listës Serbe, mbi bazën se një ligj i tillë është në kundërshtim me procesin e decentralizimit.*

## Përshkrim i Problemit

Qeveria e Republikës së Kosovës ka theksuar se zhvillimi ekonomik i nxitur nga investimet në sektorin privat është rruga që duhet ndjekur Kosova. Reformat në mjedisin e të bërit biznes kanë përmirësuar situatën në aspekt burokratik në masë të madhe, gjë që është reflektuar edhe në përmirësimin e rangimit të Kosovës në disa indikatorë. Përderisa përmirësimet në mjedis afarist janë padyshim të mirëseardhura për sektorin privat, rezultatet e nxitjes së investimeve në sektorin privat nuk kanë qenë shumë inkurajuese.

Veçanërisht shqetësuese janë të dhënat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD), që tregojnë se pavarësisht përpjekjeve, Kosova nuk ka arritur të tërheqë vëmendjen e investitorëve potencial. Grafi në vijim pasqyron fluksin e IHD-ve në Kosovë në periudhën 2009-2015:




Figura 1 IHD në Kosovë (të dhëna të nxjerra nga Banka Qendrore e Kosovës)

Grafi tregon se trendi i IHD në vendin tonë nuk ka qenë i kënaqshëm gjatë këtyre viteve. Përpos të dhënave vjetore më lartë, vlen të theksohet se IHD në periudhën Janar-Gusht 2016, ishin vetëm 148 milionë euro (Banka Qendrore e Kosovës, 2016). Një rishikim më i detajuar i të dhënave tregon se një përqindje e konsiderueshme e këtyre investimeve përbëhet nga investimet në patundshmëri (blerjet e apartamenteve të diasporës në Kosovë). Përderisa këto investime janë të mirëseardhura për shkak të mjeteve të reja që hyjnë në Kosovë, ato nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit, dhe rrjedhimisht nuk ndikojnë në masë të madhe në zhvillim ekonomik.

Kjo situatë kërkon një analizim të kujdesshëm në mënyrë që të identifikohen faktorët që

shkaktojnë hezitimin e investitorëve të huaj karshi Kosovës. Disa nga faktorët dekurajues padyshim se janë edhe sfidat e ballafaquara deri tani sa i përket sundimit të ligjit, zbatimit të kontratave, si dhe stabiliteti dhe parashikueshmëria politike. Faktorët e tillë rrisin rrezikun e investimit në një vend dhe largojnë investimet. Prandaj, vëmendje më e madhe duhet kushtuar në luftimin e dukurive të tilla.

Megjithatë, një sfidë tjetër që është raportuar në vazhdimësi përgjatë viteve është edhe kërkesat e tepërta burokratike dhe mungesa e një kornize adekuate ligjore për t'u ofruar investitorëve të interesuar lehtësira të ndryshme (vendorë apo ndërkombëtar). Një element dekurajues që duhet theksuar është fakti që komunat kanë hasur në sfida të shumta sa i përket mundësive për dhënien e pronave në shfrytëzim për investitorët e ndryshëm. Për më shumë, pas vendosjes së veprimtarisë së tyre në Kosovë, investitorët duhet të ballafaqohen me një numër të madh të institucioneve, dhe ndonjëherë procedurat e tejkujtura burokratike (siç është marrja e lejeve dhe licencave) bëhen të papërbalueshme.

Kjo ka krijuar një situatë ku Kosova ka humbur konkurrueshmërinë e saj karshi vendeve të rajonit, veçanërisht kur merret parasysh fakti se institucionet e këtyre shteteve kanë mundur të 'negociojnë' në mënyrë më të strukturuar me investitorë. Duke marrë parasysh këto sfida, Qeveria e ka identifikuar nevojën për nxjerrjen e një ligji të veçantë, që do t'i mundësonte një qasje më të personalizuar investitorëve potencial. Ligji për Investimet Strategjike ka për qëllim të mundësojë një qasje të tillë dhe të hapë rrugën për zhvillimin e procedurave të përsheptuara që të ndihmojë investitorët strategjikë në përpjekjet e tyre për të investuar në Kosovë.

## Qëllimi dhe fushëveprimi i Ligjit

### Neni 1 Qëllimi

*Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strateaike..*

Përpos definicionit të mësipërm, Neni 1 i Ligjit Nr. 05/ L-079 për Investimet Strategjike qartëson se institucionet e përfshira në këtë proces duhet të sigurohen që të respektohen parimet e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si dhe të veprojnë në përputhshmëri me Ligjin për Ndihmën Shtetërore dhe me obligimet e dala nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 1).

Duhet theksuar që qysh në nenin e parë të ligjit theksohet nevoja e krijimit të procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës publike për investitorët strategjikë.

Neni 2 i Ligjit rregullon fushëveprimin e tij dhe kriteret e përgjithshme që duhet përmbushur në mënyrë që një investim të konsiderohet strategjik sipas kuptimit të këtij ligji.

Sektori/Industria	Investimi minimal
<b>Energji me infrastrukturë dhe miniera</b>	30 Milion Euro
<b>Transport dhe telekomunikacion</b>	30 Milion Euro
<b>Turizëm</b>	20 Milion Euro
<b>Industri Përpunuese</b>	20 Milion Euro
<b>Bujqësi dhe industri ushqimore</b>	10 Milion Euro
<b>Shëndetësi</b>	30 Milion Euro
<b>Parqe industriale dhe teknologjike</b>	10 Milion Euro
<b>Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave</b>	10 Milion Euro

Një nga pjesët në vijim do të analizojë këto kritere në kontekst rajonal. Duhet theksuar se versioni i mëhershëm i projektligjit ka përfshirë edhe numrin e vendeve të reja të punës si kriter determinues për dhënien e statusit të investitorit strategjik aplikuesit. Megjithatë, versioni final i ligjit vetëm thekson se prioritet do t'i jepet projekteve me vlerë më të madhe dhe projekteve që pritet të gjenerojnë numër më të madh të vendeve të punës ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 2). Kushtet e mëposhtme gjithashtu duhet të plotësohen para se investitorët të mund të aplikojnë për statusin "strategjik":

- *Subjekti investues në momentin e aplikimit për marrjen e statusit investime strategjike duhet të paraqesë dëshmi për aftësinë e tij të mjaftueshme financiare për realizimin e investimeve;*
- *Investimet e propozuara duhen të jenë në pajtueshmëri me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian;*
- *investimet e propozuara nuk duhet të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe më obligimet e Republikës së Kosovës të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 2).*

### Shërbimet ndaj investitorëve strategjikë

Investitorët që marrin statusin strategjik do të përfitojnë një numër të shërbimeve për t'iu lehtësuar veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës. Këto shërbime variojnë nga asistenca në procedura administrative deri tek dhënia e pronave publike në shfrytëzim për periudha deri 99 vjeçare.

#### Neni 16

##### **Shërbimet ndaj investitorit pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik**

\*\*\*

- 1.1. ndihmë në procedurat administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve pranë institucioneve publike;
- 1.2. ndihmë në kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve që nevojiten për fillimin e procedurave administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve;
- 1.3. procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesave të cilat ndërlidhen me përgatitjen dhe zbatimin e projektit strategjik;
- 1.4. përkrahje për qasje në infrastrukturë bazike, në përputhje me Ligjin përkatës për Ndihmë Shtetërore;
- 1.5. vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.

Sa i përket Nenit 16.1.1, ligji parasheh afate strikte kohore për procesimin e aplikimit për leje dhe licenca. Neni 16.2 i ligjit thekson se pas pranimit të dokumentacionit të plotë, Grupi Operacional dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë janë të detyruara që **brenda 5 ditëve të punës** ta përcjellin aplikimin tek institucioni publik përkatës. Rrjedhimisht, institucioni publik është i obliguar të shqyrtojë aplikacionin dhe të japë përgjigje mbi aplikacionin **brenda 15 ditëve të punës** pas datës së pranimit. Ky afat mund të zgjatet vetëm edhe për 15 ditë të punës në raste specifike të arsyetueshme, kur kërkesa është e ndonjë natyre më komplekse.

#### Dhënia e pronës publike në shfrytëzim

Ashtu siç u përmend më herët, një ndër përfitimet kryesore të Ligjit për Investime Strategjike është mundësia e dhënies në shfrytëzim të pronës publike për investitorët strategjikë. Nenet 18 dhe 22-25 rregullojnë çështjen e dhënies së pronës publike në shfrytëzim dhe procedurat e aplikueshme. Duhet të theksohet se në mënyrë që të sigurohet një nivel i kënaqshëm i transparencës dhe llogaridhënies, ligji parasheh që transferimi i pronës shoqërore

dhe pronës publike duhet të votohet në Kuvend ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 22). Për më shumë, ligji thekson se rregulli i shumicës së thjeshtë do të përdoret për votim. Ky rol i jepet kuvendeve komunale në rastet kur kemi të bëjmë me pronë komunale. Padyshim, se kjo kërkesë ka aspektet pozitive, por edhe ato negative.

Përderisa votimi në kuvend rritë transparencën dhe llogaridhënien, kjo procedurë shkakton burokraci shtesë dhe kohë më të gjatë të pritjes për investitorë. Fatkeqësisht, në të kaluarën kemi qenë dëshmitarë të vonesave në procese të votimit për ligje të ndryshme që prekin sektorin privat, si rezultat i mosmarrëveshjeve politike.

Sipas nenit 24 të ligjit, periudha maksimale për dhënien e pronës në shfrytëzim është **99 vite**, me mundësi zgjatjeje nëse subjekti ka ndërtuar objekte që shfrytëzohen në mënyrë aktive për qëllime afariste. Ky është një përmirësim i dukshëm krahasuar me draftin e dërguar nga Qeveria në Kuvend, ku periudha maksimale ishte 40 vite.

### Aspekte Procedurale

Procedurat për marrjen e statusit të investitorit strategjik janë të ndryshme, varësisht prej asaj se kush është iniciatori i projektit. Fillimisht, në përputhje me nenin 4 të ligjit, subjektet që mund të marrin këtë status janë: (1) investitorët e huaj, (2) investitorët e brendshëm, (3) autoritetet investuese publike dhe (4) ndonjë autoritet investues publik në bashkëpunim me ndonjë investitor të huaj apo vendas ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 4.1).

*Mundësia e parë:* një investitor i interesuar mund të paraqesë kërkesën pranë Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve për të marrë statusin e investitorit strategjik. Pas aprovimit të kërkesës nga ana e Qeverisë së Kosovës, subjekti investues do të hyjë në negociatë me Komisionin Ndërmarrës për lidhjen e marrëveshjes për Investim Strategjik

### Neni 5

#### **Përmbajtja e kërkesës për marrjen e statusit investim strategjik**

2. Kërkesa e investitorit duhet të përmbajë elemente të cilat veçanërisht duhet të përfshijnë:

2.1. lokacionin e investimit;

2.2. raportin e auditimit për entitetin investues për një periudhë të caktuar kohore;

2.3. profilin e detajuar të entitetit investues duke përfshirë filialet;

2.4. referenca të mëparshme të përvojës së investitorit në projekte të ngjashme;

2.5. përshkrimin e si do të financohet projekti;

2.6. autorizimin me shkrim të entitetit investues që autorizon Agjencinë për Investime dhe Mbështetje të Investimeve që të bëjë të gjitha verifikimet dhe kontrollimet e të dhënave të paraqitura në dosjen e entitetit investues;

2.7. një pasqyre financiare dhe llogari të Humbjeve dhe Fitimeve për tri (3) vitet e fundit financiare.

("Ligji për Investimet Strategjike", Nenet 4.2 dhe 4.3). Kërkesa e subjektit duhet të përmbajë dokumentet në vijim: planin e biznesit të investimit, planin financiar dhe programin e punës për realizimin e investimit strategjik për kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të jetë më e shkurtër se pesë (5) vjet.

Nëse një subjekt krijohet me qëllim të aplikimit për një projekt të investimit strategjik, aplikuesi duhet të paraqesë të dhëna për kompaninë ëmë dhe partnerët e projektit (nëse e aplikueshme).

*Mundësia e Dytë:* në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, Qeveria mund të ftojë subjektet të aplikojnë për përzgjedhjen e subjekteve investuese për realizimin e një projekti strategjik, nëse vlerësohet se procedurat e prokurimit publik arrijnë interesin publik të Republikës së Kosovës ("Ligji për Investime Strategjike", Neni 4.4).

*Mundësia e Tretë:* Qeveria gjithashtu mund të hyjë në negociatë të drejtpërdrejta për lidhjen e Marrëveshjes për Investim Strategjik, pa ndjekjen e procedurave paraprake, nëse një gjë e tillë parashihet në bazë të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare në mes

Republikës së Kosovës dhe një apo më shumë shteteve apo organizatave ndërkombëtare ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 4.5).

Gjithashtu, vlen të theksohet se "Qeveria e Kosovës në bazë të prioriteteve zhvillimore harton një listë projektsh potenciale të investimeve strategjike në pajtim më nenin 2 të këtij ligji, si dhe me një shpallje publike fton investitorët potencial strategjik për realizimin e këtyre projekteve" ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 4.6).

### Korniza Institucionale

Ligji parasheh përfshirjen e një numri të institucioneve me role të ndryshme në procesin e përzgjedhjes, mbikëqyrjes, negocimit etj. Rolet e këtyre institucioneve janë sqaruar në këtë pjesë.

### Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Në kontekst të investimeve strategjike, KIESA ka rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe koordinimin e të gjitha procedurave. Përpos të qenit pika e parë e kontaktit për subjektet e interesuara, KIESA është gjithashtu përgjegjëse për:

- Përcaktimin dhe përshkrimin e detyrave për autoritetet përkatëse publike për zbatimin e investimeve strategjike dhe informimin e investitorit
- Asistimin e investitorit strategjik në aktivitete që kanë të bëjnë me performancën e projektit, përfshirë përgatitjen e listës së dokumenteve të nevojshme për të përfituar nga procedurat e përshpejtuara.
- Koordinimin dhe asistimin e autoriteteve publike për përpilimin e dokumenteve të nevojshme për zbatim të projektit.
- Vlerësimin teknik të investimit strategjik, duke përfshirë potencialin strategjik, riskun operacional dhe

planin e veprimit për zbatimin e projektit.

- Analizimin e profilit dhe potencialit të investitorit strategjik, dhe rrjedhimisht i lejohet kërkesa e dokumentacionit shtesë nga aplikuesi (p.sh. kapaciteti financiar).
- Propozimin ndaj Komitetit për pranimin, refuzimin apo anulimin e statusit të investitorit strategjik ("Ligji për Investime Strategjike", Neni 8).

Bazuar në përgjegjësitë e caktuara për KIESA dhe grupin operacional (sqaruar në vijim), duhet theksuar se kapacitetet njerëzore dhe profesionale të agjencisë duhet të rriten në mënyrë që të përballojë përgjegjësitë e shtuara. Disa nga këto përgjegjësi, kërkojnë kapacitete të mëdha profesionale për fusha të caktuara. Sipas nenit 11 të Ligjit, koha për kryerjen e analizave teknike, financiare dhe ligjore nga KIESA është 20 ditë pune.

Gjithashtu, KIESA "themelon dhe mbanë një regjistër për të gjithë projektet potenciale strategjike të përgatitura nga autoritetet publike dhe listën e pronave për realizimin e projekteve strategjike." ("Ligji për Investimet Strategjike", Neni 20).

### Komisioni ndërministror për investime strategjike

#### *Përbërja e Komisionit ndërministror*

1. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, kryesues;
2. Ministri i Financave;
3. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ;
4. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
5. Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
6. një (1) Ministër nga komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë;;
7. Kryetari i komunës në të cilën realizohet investimi strategjik;
8. Ministri i ministrisë në të cilën realizohet investimi strategjik;
9. Avokati i Përgjithshëm Shtetëror.



Këto komisione do të themelohen me qëllim për “vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve për investime strategjike”. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë do të shërbejë si kryesues i komisionit dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe udhëheqjen e punës së komisioneve (“Ligji për Investimet Strategjike”, Neni 6). Rregulli i shumicës së thjeshtë do të vlejë për votime.

Roli i komisionit është tejet i rëndësishëm në vlerësimin e kërkesave për dhënien e statusit të investimit strategjik dhe dhënies së rekomandimit përkatës për Qeverinë. Ky vendim merret edhe duke u bazuar në rekomandimet e marra nga KIESA. Komisioni gjithashtu themelon Grupet Operacionale në kuadër të KIESA dhe publikon raporte gjashtëmujore për monitorimin dhe zbatimin e projekteve strategjike. Gjithashtu, komisioni ka për detyrë negocimin e marrëveshjes me investitorin strategjik pas aprovimit të projektit nga ana e Qeverisë.

### **Grupet Operacionale**

Grupet operacionale për zbatimin e investimeve strategjike themelohen nga komisioni dhe përfshijnë profesionistë të ndryshëm, varësisht nga projekti i investimit strategjik. Ky grup do të përfshijë përfaqësues nga të gjitha ministrinë e përfshira, komunitat dhe Zyra për Ndihmë Shtetërore. Përgjegjësia kryesore e grupeve operacionale është ofrimi i mbështetjes profesionale për KIESA në zbatimin e aktiviteteve të projektit (“Ligji për Investimet Strategjike”, Neni 9).

### **Qeveria e Kosovës**

Qeveria e Kosovës është autoriteti vendimtar për dhënien apo refuzimin e statusit të investimit strategjik. Megjithatë, duhet të theksohet fakti që pas rekomandimit të komisionit, Qeveria mund të ndryshojë vendimin e tyre (aprovim apo refuzim) vetëm nëse kriteret e parapara në ligj nuk plotësohen. Qeveria gjithashtu ngarkohet me përgatitjen e vendimeve për investimet strategjike, bazuar në kriteret e parapara në Nenin 12.

### **Kuvendi i Kosovës dhe Kuvendet Komunale**

Siç u sqarua më parë, roli i kuvendit dhe i kuvendeve komunale përfshinë votimin për transferimin e pronës publike, shoqërore apo komunale për investimet strategjike.

### **Kornizat e Investimeve Strategjike në Shtetet Tjera**

Shtetet e ndryshme zbatojnë strategji të ndryshme sa i përket nxitjes së investimeve vendore dhe investimeve të huaja direkte. Legjislacioni dhe korniza mbështetëse e një numër të shteteve tjera është në fokus të këtij seksioni të publikimit.

### **Korniza e Bashkimit Evropian**

Në nivel të Bashkimit Evropian, politikat për tërheqjen e investimeve mbesin në diskrecion të vendeve anëtare përderisa të njëjtat janë në përputhshmëri me legjislacionin dhe parimet e BE-së. Megjithatë, investime strategjike llogariten ato të cilat bëhen drejt zbatimit të parimeve të “Evropa 2020 – një strategji për zhvillim të mençur, qëndrueshëm, dhe gjithëpërfshirës” që ka për qëllim rritjen ekonomike dhe krijim të vendeve të punës (Komisioni Evropian, 2015).

Në këtë drejtim, Bashkimi Evropian ka aprovuar një Plan Investiv i cili fokusohet në largimin e pengesave për investime, ofrimin e vizibilitetit dhe asistencës teknike drejt projekteve investive. Për të arritur këto qëllime, plani fokusohet në mobilizim të investimeve në vlerë prej të paktën 315 miliardë euro, mbështetje të investimeve në ekonominë reale, dhe krijim të një ambienti të përshtatshëm për investime. Gjithashtu, BE ka themeluar edhe Fondin Evropian për Investime Strategjike, i cili do të mbështetë investimet në projekte ekonomikisht të qëndrueshme dhe vlerë të lartë të shtuar, duke u fokusuar në:

- Infrastrukturë strategjike, përfshirë atë digjitale, transportin, dhe energjinë
- Edukim, hulumtim, zhvillim, dhe inovacion

- Zgjerim të energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencës së burimeve, dhe
- Mbështetje për biznese të vogla dhe të mesme

Në këtë kuptim, si në BE edhe në vendet tjera, investimet e bëra në sektorët strategjik të një vendi llogariten si investime strategjike, të cilat drejtohen drejt arritjes së qëllimeve afatgjata zhvillimore të një vendi. (Komisioni Evropian, 2015)

### Kroacia

Kroacia ka një ligj për Investimet Strategjike që përfshin një numër të madh të sektorëve: ekonomi, energji, turizëm, transport dhe infrastrukturë, komunikime elektronike dhe shërbime postare, mbrojtja e mjedisit dhe shërbimet publike, agrikulturë, pylltari, menaxhim i ujërave, peshkatari, kujdes shëndetësor, kulturë, shkencë, teknologji, edukim, mbrojtje dhe gjyqësor. Gjithashtu, ligji thekson se investime strategjike do të konsiderohen ato që ndikojnë punësimin në masë të madhe, përmirësojnë infrastrukturën e cilësisë, promovojnë përdorimin e teknologjisë për rritjen e konkurrueshmërisë, ndihmojnë qëllimet për mbrojtjen e mjedisit etj. (Agjencia Kroate për Investime dhe Konkurrueshmëri).

Kriteret e mëposhtme përdoren për të definuar investimet strategjike:

- Në përgjithësi, investimet mbi € 20 Milion
- Investimet mbi € 10 milion, nëse bashkëfinancohen me fonde të BE

- Investimet mbi € 3 milion, nëse projekti zbatohet në zonat më pak të zhvilluara
- Investime mbi € 3 milion nëse investimi është në ndonjë ishull
- Investime mbi € 3 milion nëse investimi është në agrikulturë or peshkatari.

Ngjashëm si në Kosovë, përfitimet kryesore që investitorët strategjikë kanë në Kroaci përfshinë procedurat e përsheptuara administrative për leje dhe licenca dhe qasja në pronën publike për periudhë 99 vjeçare. (Agjencia Kroate për Investime dhe Konkurrueshmëri).

### Shqipëria

Në vitin 2015, Shqipëria miratoi Ligjin për Investime Strategjike, me qëllim të stimulimit të investimeve vendore dhe të huaja. Ligji bën dallimin mes dy llojeve të investimeve strategjike: procedura e asistuar dhe procedura speciale. Llojet e shërbimeve për të dyja procedurat ndryshojnë. Sektorët dhe vlerat respektive të investimit minimal për investimet strategjike në Shqipëri janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Shërbimet e ofruara për investitorët strategjikë në përgjithësi janë të njëjta me ato të ofruara në Kosovë dhe Kroaci, pra procedurat e lehtësuara për leje dhe licenca dhe përdorimi i pronës publike për zbatimin e projektit të investimit strategjik. Megjithatë, duhet theksuar se ligji në Shqipëri përmban dispozita për shpronësimin e pronave private për implementimin e investimeve strategjike: procedura speciale. Gjithashtu, ligji i jep

SEKTORI	PROCEDURA E ASISTUAR	PROCEDURA SPECIALE
ENERGJI DHE MINIERA	€ 30 M	€ 50 M
TRANSPORT, INFRASTRUKTURË, KOMUNIKIME ELEKTRONIKE DHE MENAXHIMI I MBETJEVE	€ 30 M	€ 50 M
TURIZËM	€ 5 M + 80 vende pune	€ 50 M
AGRIKULTURË DHE PESHKATARI	€ 3 M + 50 vende pune	€ 50 M
ZONAT E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK	€ 5 M	€ 50 M
ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI	€ 1 M + 150 vende pune	€ 10 M + 600 vende pune

Figura 2 Sektorët e Investimeve strategjike në Shqipëri

Këshillit të Ministrave (Qeverisë) fuqi dhe përgjegjësi të mëdha në procedura të tilla. Për më shumë, investitori strategjik në procedurën speciale mund të kërkojë që marrëveshja me Këshillin e Ministrave të dërgohet për votim në Kuvend, me qëllim që të ulet rreziku politik dhe ligjor (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2015).

## Serbia

Serbia nuk ka ligj të dedikuar për investimet strategjike; megjithatë, mundohet të ndjek politika që synojnë të nxisin investimet vendore dhe të huaja në sektorë të ndryshëm. Në përgjithësi, korniza nacionale konsideron aktivitetet ekonomike me vlerë të lartë të shtuar dhe ato që i ekspozohen tregtisë ndërkombëtare si aktivitete me rëndësi strategjike. Investimet në këtë kategori përfshijnë:

- Projektet investive standarde - investimet në mjete themelore deri në 50 milionë euro
- Projektet e mëdha investive - investimet mbi 50 milion euro
- Investimet e rëndësishme të veçantë - investime mbi 20 milion euro ose 500 vende të reja të punës, si dhe investime mbi 5 milion euro ose 200 vende të punës në komunat më pak të zhvilluara të Serbisë (Qeveria e Republikës së Serbisë, 2012)

Përpos politikave fleksibile për njohjen e shpenzimeve të zbritshme dhe pushimet tatimore, Qeveria e Serbisë poashtu aplikon subvencionime të pagave për nxitjen e punësimit dhe inkurajimin e investimeve në sektorin privat. Stimujt e punësimit (për vend të ri të punës), janë sqaruar më poshtë:

<b>Komunat e Gr. I</b>	20%, por jo më shumë se € 3,000
<b>Komunat e Gr. II</b>	25% por jo më shumë se € 4,000
<b>Komunat e Gr. III</b>	30% por jo më shumë se € 5,000

<b>Komunat e Gr. IV</b>	35% por jo më shumë se € 6,000
<b>Komunat e nënzhvilluara</b>	40% por jo më shumë se € 7,000

Përkundër mungesës së një ligji për Investimet Strategjike, investitorët në Serbi mund të marrin pronën publike në shfrytëzim për periudhë deri 99 vjeçare, bazuar në legjislacionin në fuqi (Kuvendi i Republikës së Serbisë, "Ligji mbi Pronën Publike").

## Maqedonia

Ngjashëm si në Serbi, as Maqedonia nuk ka një Ligj mbi Investimet Strategjike. Megjithatë, Qeveria e Maqedonisë dhe institucionet përgjegjëse mundohen të nxisin investimet përmes Zonave për Zhvillim të Teknologjisë dhe Industrisë. Këto zona i ofrojnë investitorëve qasje në tokë për periudha 10-99 vjeçare, dhe qasje në infrastrukturë mbështetëse. Disa nga stimujt e ofruara për investitorët në këto zona janë:

- Pushime tatimore për periudhë deri 10 vjeçare
- Lirime nga detyrimet doganore
- Qasje e lehtë në infrastrukturë
- Përdorimi i pronës publike për periudhë deri 99 vjeçare (PricewaterhouseCoopers, 2016)

Kompanitë me projekte që përmbushin kriteret e mëposhtme kanë prioritet për t'u vendosur në këto zona: rritja e punësimit, kompanitë që punojnë me certifikata të prodhimit që janë në përputhje me standardet mjedisore, prodhimtaria me vlerë të lartë të shtuar, projektet për eficiencë të energjisë etj.

## Hapat e mëtutjeshëm

Përderisa Ligji për Investimet Strategjike mund të konsiderohet si hap pozitiv për përpjekjet e Kosovës për nxitjen e investimeve në sektor privat (veçanërisht IHD), disa çështje vlen të ritheksohen:



Fillimisht, kapacitetet e institucioneve zbatuese, veçanërisht KIESA, duhet të rriten dukshëm, në mënyrë që të nxirren përfitimet nga ky ligj. Shumë nga aktivitetet dhe përgjegjësitë e përshkruara në ligj kërkojnë ekspertizë të detajuar profesionale mbi fushën përkatëse.

Institucionet respektive, veçanërisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, duhet të promovojnë këtë mekanizëm të ri para investitorëve potencial, qofshin ata vendorë apo të huaj. Ligji në Shqipëri përmend në mënyrë specifike se Agjencia duhet të rrisë përpjekjet për promovimin e ligjit para investitorëve potencial në panairë dhe konferenca ndërkombëtare.

Çfarëdo reforme në mjedisin e të bërit biznes dhe investimeve nuk do të ketë rezultatet e dëshiruara pa përmirësuar dukshëm situatën sa i përket sundimit të ligjit dhe zbatimit të kontratave. Kjo edhe ka qenë pengesa më e madhe për Kosovën në aspekt të nxitjes së IHD-ve që nga shpallja e pavarësisë. Përmirësimet në sundimin e ligjit do të ulnin rrezikun e investimit dhe do të nxiste investitorët që të konsiderojnë Kosovën si destinacion për investime.

Për fund, vlen të theksohet që në përputhje me Ligjin për të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjin për Mallrat e Liruara nga detyrimet Doganore, Ministria e Financave duhet të hartojë UA mbi Pushimet Tatimore dhe duhet të zgjerojë listën e mallrave të liruara nga detyrimet. Hapa të tillë janë veçanërisht të mirëpritura për kompani që kërkojnë të investojnë në procese të prodhimit apo përpunimit.

#### **Akronimet**

**BQK** – Banka Qendrore e Kosovës

**IHD** – Investimet e Huaja Direkte

**NVM** – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

**KIESA** – Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë

#### **Referencat**

Agjencia Kroate për Investime dhe Konkurrueshmëri. (a.d.). Udhëzues për investitorë: Ligji për Projektet e Investimeve Strategjike në Republikën e Kroacisë. Agjencia Kroate për Investime dhe Konkurrueshmëri. Gjetur në [http://www.aik-invest.hr/wp-content/uploads/2015/01/Act-on-Strategic-Investment-Projects\\_Investors-Guide.pdf](http://www.aik-invest.hr/wp-content/uploads/2015/01/Act-on-Strategic-Investment-Projects_Investors-Guide.pdf)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. (2016, Shtator). Buletini Mujo Statistikor. Prishtinë, Kosovë: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Gjetur në [http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/CB\\_K\\_MSB\\_181\\_en..pdf](http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/CB_K_MSB_181_en..pdf)

Komisioni Evropian. (2015, Korrik 22). Plani i Investimeve për Evropë: Fondi për Investime Strategjike gati për lansim në vjeshtë. Bruksel, Belgjikë: Komisioni Evropian. Gjetur në [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-15-5420\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-5420_en.htm)

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2016). Ligji Nr.05/ L-079 për Investimet Strategjike. Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. (2015, Maj 28). Ligji 55/2015 për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë. Tiranë, Shqipëri. Gjetur në [http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Ligj\\_55\\_2015.pdf](http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Ligj_55_2015.pdf)

Parliament of the Republic of Serbia. (a.d.). Law on Public Property. Belgrade, Serbia.

PricewaterhouseCoopers. (2016, Shkurt).  
Udhëzues për të Bërit Biznes dhe  
Investime në Maqedoni 2016.  
Gjetur në  
[https://www.pwc.com/mk/en/publications/assets/doing\\_business\\_guide\\_macedonia\\_2016.pdf](https://www.pwc.com/mk/en/publications/assets/doing_business_guide_macedonia_2016.pdf)

Qeveria e Republikës së Serbisë. (2012).  
Rregullore për nxitjen e  
Investimeve të Huaja Direkte.  
Beograd, Serbi.